



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, par.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.03.2005 merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
PRISHTINËS NR. 01-35-316, DT. 12.03.2002

- I. Neni 2 i Vendimit, nga pika I, ndryshohet dhe bëhet: “Pjesës së ngastrës kadastrale nr. 851/1, komuna kadastrale e Prishtinës, pronë e Komunës, i ndryshohet destinimi, nga ai i paraparë si sipërfaqe për gjelbërim, në atë si tokë ndërtimore, kështu që sipërfaqëja prej 9.60 arë, destinohet për ndërtimin e postës, ndërsa sipërfaqëja prej 1.84.00 ha, për ndërtimin e objektit të shkollës fillore”.
- II. Ndryshimi, sipas këtij Vendimi, do të bëhet edhe në pjesët grafike të Planit detal të lagjes “Vreshta” në Prishtinë.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.031-7327 dt. 05.04.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri